



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.07.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., e dt.07.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121,, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 02.06.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 02.06.2025;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.



Arsyetim

Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., me dt.07.07.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dyshemeve dhe blerja e gjeneratorëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara, sepse ISO 9001:2015, ISO 22000:2005 për pozicionin 2- Enlarese profesionale dhe pozicionin 4- Kazan Bojler per zierje dhe Certifikatën CE,, janë kërkuar te paramasa dhe parallogaria.

Ju si Operator Ekonomik për pozicionin 2- Enlarese profesionale dhe pozicionin 4- Kazan Bojler per zierje nuk keni prezentuar ISO 9001:2015, ISO 22000:2005 dhe Certifikatën CE.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
